



Data: 12/08/21 Ref.: 3014/21

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës Nr.06/L-113(Gazeta Zyrtare Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-31 (Gazeta Zyrtare Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037(Gazeta Zyrtare Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), si dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 87-të, të mbajtur më 07 dhe 27 Korrik 2021, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditoohen programet e studimit të Fakulteti të Inxhinierisë Mekanike, të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, për periudhën pesë vjeçare, 1 tetor 2021 – 30 shtator 2026:
 - Mekatronikë, BSc, 180 ECTS, maksimumi 90 studentë për vit akademik;
 - Mekatronikë, MSc, 120 ECTS, maksimumi 30 studentë për vit akademik;
- II. Riakreditoohen programet e studimit, për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2021 – 30 shtator 2024:
 - Termoenergjetike dhe Energji e Ripërtërishme, BSc, 180 ECTS, maksimumi 90 studentë për vit akademik;
 - Termoenergjetike dhe Energji e Ripërtërishme, MSc, 120 ECTS, me specializime: 1. Termoenergjetikë dhe Termoteknikë; 2. Sistemet e Energjisë së Ripërtërishme, maksimumi 30 studentë për vit akademik;
- III. Nuk akreditoohen programet e studimit:
 - Prodhimtari dhe Inxhinieri Industriale me Menaxhment, BSc, 180 ECTS me specializim: 1. Prodhimtari dhe Automatizim; 2. Inxhinieria Industriale me Menaxhment.
 - Prodhimtari dhe Inxhinieri Industriale me Menaxhment, MSc, 180 ECTS me specializim: 1. Prodhimtari dhe Automatizim; 2. Inxhinieria Industriale me Menaxhment.
- IV. Numri i përcaktuar i studentëve aplikohet për të gjitha vitet e studimit për periudhën e akreditimit.
- V. Obligohet Fakulteti të Inxhinierisë Mekanike që deri më datë 15 nëntor të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetime

I. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim dhe akreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në tabelën e mëposhtme:

<i>Nr.</i>	<i>Programi i studimit</i>	<i>Bartësit e programit</i>
1	Mekatronikë, BSc, 180 ECTS	Arbnor Pajaziti Xhevahir Bajrami Shpetim Lajqi
2	Mekatronikë, MSc, 120 ECTS	Ahmet Shala Rame Likaj
3	Termoenergjetike dhe Energji e Ripërtërishme, BSc, 180 ECTS	Rexhep Selimaj Bedri Dragusha Drenusha Krasniqi
4	Termoenergjetike dhe Energji e Ripërtërishme, MSc, 120 ECTS, me specializime: 1. Termoenergjetikë dhe Termoteknikë; 2. Sistemet e Energjisë së Ripërtërishme	Xhevat Berisha Naser Sahiti Fitore Mustafa Abdullahu
5	Prodhimtari dhe Inxhinieri Industriale me Menaxhment, BSc, 180 ECTS me specializim: 1. Prodhimtari dhe Automatizim; 2. Inxhinieria Industriale me Menaxhment.	Hysni Osmani Mirlind Bruçi Afrim Gjellaj Beqir Hamidi
6	Prodhimtari dhe Inxhinieri Industriale me Menaxhment, MSc, 180 ECTS me specializim: 1. Prodhimtari dhe Automatizim; 2. Inxhinieria Industriale me Menaxhment.	Agron Pajaziti Ferit Idrizi Shkelzen Shabani

Çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit, duhet të raportohet dhe arsyetohet në AKA brenda 90 ditëve. Lista e përditësuar duhet të aprovohet nga KSHC.

AKA ka organizuar një vizitë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Fakulteti të Inxhinierisë Mekanike me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit.

Vizitat janë organizuar më 23.03.2021 me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Drazen Vrhovski, Laura Palac, Peeter Normak, Gabor Dombay.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të Ekspertëve Ndërkombëtarë kanë hartuar raportet e vlerësimit, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit Mekatronikë, BSc, 180 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush plotësisht një (1) kapitull dhe substancialisht gjashtë (6) kapituj.

2. Për programin e studimit Mekatronikë, MSc, 120 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush plotësisht tre (3) kapituj dhe substancialisht katër (4).

3. Për programin e studimit Termoenergjetike dhe Energji e Ripërtërishme, BSc, 180 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush plotësisht tre (3) kapituj dhe substancialisht katër (4) kapituj.

4. Për programin e studimit Termoenergjetike dhe Energji e Ripërtërishme, MSc, 120 ECTS, me specializime: 1. Termoenergjetikë dhe Termoteknikë; 2. Sistemet e Energjisë së Ripërtërishme - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush substancialisht katër (4) kapituj dhe pjesërisht tri (3) kapituj.

5. Për programin e studimit Prodhimtari dhe Inxhinieri Industriale me Menaxhment, BSc, 180 ECTS me specializim: 1. Prodhimtari dhe Automatizim; 2. Inxhinieria Industriale me Menaxhment - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush substancialisht dy (2) kapituj dhe pjesërisht pesë (5) kapituj.

6. Për programin e studimit Prodhimtari dhe Inxhinieri Industriale me Menaxhment, MSc, 180 ECTS me specializim: 1. Prodhimtari dhe Automatizim; 2. Inxhinieria Industriale me Menaxhment - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush substancialisht dy (2) kapituj dhe pjesërisht pesë (5) kapituj.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e 87 të mbajtur më 07 dhe 27 korrik 2021 kanë shqyrtuar aplikacionin e Fakulteti të Inxhinierisë Mekanike dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerrë këtë vendim bazuar në Nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.


Prof. Ass. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare i Këshillit Shtetëror të Cilësisë



Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.